



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) lidhur me nenin 17 dhe 40, të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", nenit 15, lidhur me nenin 28 dhe 29, paragrafi 2, pika (d) të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 27.03.2018, miraton këtë:

VEN D I M

Neni 1

MIRATOHET-kërkesa e Qendrës së biznesit me seli në Suharekë me numër të protokollit 01-Nr-016-12785, e datës 21.03.2018, për iniciimin e procedurës në organet kompetente për shqyrtimin e mundësisë së qasjes për një hyrje-dalje për në zonën ekonomike respektivisht në "Parkun Industrial në Shirokë" të Komunës së Suharekës për në autostradën ndërkombëtare "Ibrahim Rugova".

Neni 2

AUTORIZOHET, Kryetari i Komunës, që të kompletton të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, konform Ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe të iniciion procedurën në organet kompetente për shqyrtimin e mundësisë së qasjes për një hyrje-dalje për në zonën ekonomike respektivisht në "Parkun Industrial në Shirokë" të Komunës së Suharekës për në autostradën ndërkombëtare "Ibrahim Rugova", me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira të bizneseve që janë të vendosura në atë zonë ekonomike respektivisht "Park Industrial në Shirokë" dhe largimin e rrezikut që mund të shkaktohet nga automjetet e rënda, të cilat kalojnë nëpër qendër të qytetit të Suharekës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim liron në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpaljes publike në tabelën e shpalljeve ose në faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS - SUHAREKË

01-Nr-101-13981
Me datë 28.03.2018



Kryesuesi i Kuvendit
Bexhet KUV